

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, si gjykatë civile e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Makifete Saliuka, kryetare dhe Kujtim Pasuli e Nenad Llaziq, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit F.P. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim Z.I., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, me përfaqësuesit e autorizuar T.H. dhe D.P., jur. të dipl., për shkak të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr. 152/13, i datës 8.5.2014, në seancën e mbajtur me dt. 5.12.2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET ankesa e të paditurës dhe **VËRTETOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr. 152/13, i datës 8.5.2014.

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e goditur, me paragrafin I dhe II të dispozitivit të tij, e ka *MIRATUAR (pjesërisht) SI TË BAZUAR kërkesëpadinë e paditësit F.P. nga Prishtina, dhe duke e DETYRUAR të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 27.7.2006, t'ia paguaj paditësit shumën totale prej 6.060,00 €, me kamatë sipas lartësisë që paguhet për një vit për mjetet e depozituara pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 7.9.2006, e deri në pagesën definitive, në shumat e specifikuara si në vijim:*

- për dhimbje fizike – 1.500,00 €, për frikën e përjetuar – 1.200,00 € dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 10 %, - 2.000,00 €,
- për ndihmë dhe përkujdesje nga personi tjetër – 50,00 €, për ushqim të përforcuar – 50,00 €, për rehabilitim fizioterapeutik – 210,00 € dhe për shpenzime të shërimit – 1.050,00 €.

Me paragrafin III, DETYROHET e paditura, që në emër të shpenzimeve procedurale dhe gjyqësore t'ia paguaj paditësit shumën totale prej 1.438,00 €, dhe atë: për hartimin e padisë nga ana e avokatit – 78,00 €, për taksë gjyqësore për padi – 50,00 €, për ekspertiza mjekësore - 350,00 €, për përfaqësime për tetë seanca nga ana e avokatit – 960,00 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke konsideruar se shumat e gjykuara janë tepër të larta në krahasim me lëndimet që ka pësuar paditësi, me propozim që ankesa e saj të pranohet me ndryshimin e aktgjykimit të goditur, duke e refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit ose duke i pranuar shuma më të ulta për të gjitha format e dëmit, eventualisht të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktgjykimin të ankimuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me dispozitën e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se, me dt. 27.7.2006, në rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, në fshatin Pestovë/Vushtrri, ka ndodhë aksidenti i komunikacionit, shkaktar i të cilit ka qenë vetura e tipit "Toyota", me targa PG -908-54, e siguruar në Kompaninë Ndërkombëtare të Sigurimit në Malin e Zi, drejtuesi i të cilit duke mos e përshtatur shpejtësinë e vozitjes, kushteve e gjendjes në rrugë, si dhe pjesëtarëve tjerë në komunikacion, duke mos e mbajtur distancën e nevojshme nga automjeti tjetër, e godet nga pas veturën "Ford Fiesta", me targa 297-KS-579, e cila ka qenë duke lëvizur në drejtimin e njëjtë, e drejtuar nga paditësi këtu F.P., i cili nga goditja humb kontrollin ndaj veturës, del jashtë rrugës me ç' rast pëson lëndime trupore por edhe vetura e tij dëmtohet.

Drejtuesi i veturës me të cilën është shkaktuar aksidenti aktual B.D. nga Kenia, shtet i Afrikës Lindore, me banim të përkohshëm në Prishtinë, është shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Vushtrri, P.nr. 200/2006, i datës 11.8.2006, për vepër penale rrezik i trafikut publik nga neni 297 par. 3 lidhur me al. 1 të KPPK-së, dhe është dënuar me gjobë prej 500,00 €.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me çështjen konkrete juridike sipas padisë së paditësit e cila ka të bëjë me kompensim dëmi për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin aktual të komunikacionit, merr aktgjykimin e parë C.nr. 427/2006, i datës 31.1.2007, me të cilin e miraton në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, por që ky aktgjykim priset me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë Ac.nr. 707/2012, i datës 11.2.2013, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Kjo e fundit duke vepruar sipas vërejtjeve dhe sygjërimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë, merr aktgjykimin e fundit C.nr. 152/2013, i datës 8.5.2014, ligjshmëria dhe rregullsia e tij vlerësohet në këtë procedurë ankimore, me të cilin e miraton pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, në shumën totale prej 6.060,00 €, për të gjitha format e dëmit, ndërsa mbi këtë lartësi e refuzon si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, vendimin e saj, lidhur me natyrën e lëndimit të cilin e ka pësuar paditësi, e ka mbështetur në Mendimin e tre ekspertëve mjekësor Dr. F.B., Dr. Xh.G. dhe N.D., të gjithë, ortoped traumatolog, në QKUK në Prishtinë, e bërë me datë 26.9.2013, e caktuar për shkak se ekspertizat e mëhershme të bërë nga dy ortoped tjerë – kanë qenë të ndryshme. Tre ekspertët e fundit, përveç se janë deklaruar për natyrën e lëndimit të paditësit, i kualifikuar nga ata si lëndim i rëndë trupor (*ndrydhje e kokës dhe qafës si dhe pjesës së poshtme të kërcirit të djathtë, me rakturë parciale – shkyrje të tendinit të akilit të djathtë ...*), janë deklaruar edhe për dhimbjet fizike, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit për 10 %, nevojën e paditësit për kujdesin e huaj, për ushqim të përforcuar dhe për rehabilitim fizioterapeutik.

Ndërsa ekspertja mjekësore nga lëmi i neuropsikiatrisë Dr. M.Sh., ka vlerësuar frikën që ka përjetuar paditësi, intensitetin dhe kohëzgjatjen e saj.

Gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 13 të Ligjit për Sigurimin nga autopërgjegjësia dhe nenin 897 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, ka konstatuar drejtë se përgjegjësia për kompensimin e dëmit ndaj paditësit në këtë rast bie mbi të paditurën, duke e detyruar të njëjtën që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t'ia paguaj paditësit shumat e pranuar si në dispozitivin e aktgjykimit të goditur, me kamatë vonesë përkatëse ligjore deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se, aktgjykimi i goditur është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për shkak se, sipas saj, shumat e gjykuara janë tepër të larta dhe nuk përkojnë me natyrën e lëndimit që paditësi ka pësuar në aksidentin aktual, për shkak se shumat e gjykuara për dëmin jo material nuk janë të mëdha, dhe se janë korrekte. Ato paraqesin shpagim real për format e dëmeve që ka pësuar paditësi e qëllim që me këtë kompensim dëmi sadopak do të zvogëlohen dhembjet shpirtërore të tij për lëndimin e pësuar dhe pasojat të këtij lëndimi.

Edhe lartësitë e shumave të gjykuara për dëmin material, përfshirë këtu ndihmën nga personi i tretë, ushqimin e përforcuar dhe rehabilitim fizioterapeutik bashkë me shpenzimet e shërimit, janë reale e të bazuara në prova materiale përkatësisht në faturat e prezantuara nga paditësi të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe janë vlerësuar në detaje nga gjykata e shkallës së parë.

Si rezultat, në çështjen konkrete juridike drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale me zbatimin e nenit 154, 185, 189, 193 par. 2 dhe nenit 200 të LMD-së, prandaj aktgjykimi i goditur – vërtetohet.

Po ashtu, ky aktgjykim nuk përmban as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Për arsyet e paraqitura si më lart, Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 195 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT NE PRISHTINE
AC.nr. 2421/14, datë 5.12.2016

KRYETARJA E KOLEGJIT-GJYKATËSJA,
Makifete Saliuka